

E DREJTA PËR INFORMIM

Rezoluta “Për vlerësimin e punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023” miratohet nga Kuvendi



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, prezantoi Raportin për veprimtarinë e institucionit për vitin 2023 në punimet e Seancës Plenare të datës 04.07.2024 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Sipas procedurës, Kuvendi miratoi dhe Rezolutën “Për vlerësimin e punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023” ([Rezoluta](#)).



Vendimmarrja e Zyrës së Komisionerit

Vendim Nr. 13 - Banka OTP Albania sh.a

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit korrik 2024.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit korrik 2024, ka dhënë 1 vendim në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI"). Me vendimin nr. 13, datë 30.07.2024, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj Bankës OTP Albania sh.a.

Ankuesi, (në vijim "ankuesi"), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") ankesën nr. 1780 prot., datë 24.07.2024, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Bankës OTP Albania sh.a.

Ankuesi, nëpërmjet kërkesave datë 19.06.2024 dhe 03.07.2024 ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion dokumentacioni në lidhje me kopje të praktikës të:

1. Cedimit të kredisë dhe aktet e tjera të lidhura me këtë veprim, për të cilën jemi vënë në dijeni me shkresën me nr. 1697 prot., datë 10.05.2024.

2. "Marrëveshje Transferimi me Kalim Kredie" të lidhur midis Bankës Societe General Albania sh.a sot Banka OTP Albania sh.a., dhe z. me datë 29.12.2017 dhe aktet e tjera të lidhura me këtë veprim, për të cilën jemi vënë në dijeni me shkresën me nr. 1679/2 prot., datë 28.06.2024.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, pasi Banka OTP Albania sh.a ka kthyer përgjigje duke sqaruar "...informacioni mbi këtë kontratë konsiderohet konfidencial.", ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, në përputhje me pikën 3, të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI"), pikës 2 të nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit "Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi...", si dhe gërmës "b" të nenit 65 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: "Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative", ka verifikuar

statusin juridik të subjektit ndaj të cilit fillimi i procedurës administrative, Bankës OTP Albania sh.a.

Nga verifikimi paraprak, Banka OTP Albania sh.a., është shoqëri tregtare e regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër unik i identifikimit të subjektit K41424801U. Referuar ekstraktit të Regjistrin Tregtar për të dhënat e subjektit, rezulton se Banka OTP Albania sh.a., është një shoqëri aksionare, me 100% aksione private.

Objekti LDI është garantimi i njohjes së publikut me informacion, që prodhohet ose mbahet nga ana e autoriteteve publike.

Në kuptim të nenit 2, pika 1 e ligjit të sipërcituar "Autoritet publik":

a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njëjësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj;

b) janë shoqëritë tregtare ku:

i) shteti zotëron shumicën e aksioneve;

ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës "c" të kësaj pike;

c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Për sa më sipër parashtruar, rezulton se Banka OTP Albania sh.a., nuk është autoritet publik në kuptim të LDI. Për rrjedhojë, për shkak të mungesës së legjitimitimit të palës në këtë procedurë administrative, si subjekt i LDI, ankesa e paraqitur nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji, për të vijuar më tej procedurat për shqyrtimin e saj.

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi rrëzimin e ankesës kundër Bankës OTP Albania sh.a, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.



KONSULTONI FAQEN WWW.IDP.AL PER TU NJOHUR ME TË REJAT MË TË FUNDIT TË ZYRËS SË KOMISIONERIT

RRUGA ABDI TOPTANI, ND. 5, KODI POSTAR 1001, TIRANE | INFO@IDP.AL / +35542237200

OECD fton Zyrën e Komisionerit për të ndarë eksperiencën në fushën e të drejtës për informim, si një prej praktikave më të mira ndërkombëtare



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u ftua nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), për të marrë pjesë në aktivitetin “Rritja e aksesit në informacion në Jordani: roli i institucioneve publike në zbatimin efektiv të kuadrit të rregullator”. OECD vlerësoi autoritetin shqiptar si model për t’u ndjekur dhe për përvojën dhe standardet e larta në fushën e të drejtës për informim, arsye për të cilën u përzgjedh, së bashku me autoritetin spanjoll për të drejtën e informimit, për të ndarë eksperiencën dhe praktikën më të mira në këtë fushë.

Aktiviteti u organizua nga OECD dhe Ministria e Kulturës dhe Këshilli i Informimit të Jordanisë, ku morën pjesë mbi 80 autoritete vendase me mbi 100 përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet qendrore, si ministritë e institucione të tjera kyçe në vend. Ky shtet është i pari që miratoi një ligj për të drejtën e informimit në rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore, ndërsa prej prillit 2024 e ka përmirësuar akoma edhe më shumë atë.



Zyra e Komisionerit prezantoi një panoramë të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, funksioneve monitoruese dhe mbikëqyrëse të autoritetit, instrumentin e programit të transparencës në kuadër të transparencës proaktive të organeve të sektorit publik, si dhe veprimtarinë ndërgjegjësuere me fokus bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe grupet e interesit.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet është dëshmi e kapaciteteve në rritje të Zyrës, por edhe e vlerësimit nga organizata ndërkombëtare si OECD, duke e cilësuar Zyrën e Komisionerit si një prej autoriteteve që ka vendosur një prej praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e të drejtës për informim, për të konsoliduar edhe më shumë kulturën e transparencës për institucione publike të përgjegjshme.

E drejta për informim, forcim i kulturës së transparencës së autoriteteve publike



Njohja me kuadrin ligjor të fushës së të drejtës për informim, ishte në qendër të trajnimit të organizuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku ishin të pranishëm një grup koordinatorësh të autoriteteve të ndryshme publike, qendrore apo njësive të vetëqeverisjes vendore, të emëruar së fundmi në këtë detyrë. Në këtë aktivitet u prezantua korniza e detyrimeve që burojnë nga ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar dhe ligji 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik".

Stafi i Zyrës së Komisionerit, nëpërmjet rasteve nga praktika, i njohu pjesëmarrësit me rregullat për ushtrimin e të drejtës për të kërkuar informacion/dokumentacion me karakter publik dhe procedurën e ankesës; mbi përmbajtjen dhe përditësimin e vazhdueshëm të Programit të Transparencës, si dhe për rolin dhe veprimtarinë e koordinatorit në përmbushje të dispozitave ligjore. Nga ana tjetër, ata u njohën me risitë dhe konceptet kryesore të ligjit 33/2022, i cili ka transpozuar direktivën e BE me të njëjtën emërtesë, duke i ngarkuar një kompetencë të re Zyrës së Komisionerit në monitorimin/mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtës për ripërdorimin të informacionit të sektorit publik. Ky akt i shtrin efektet mbi një sërë kategorish informacioni që prodhohet/mbahet nga organet/sipërmarrjet e sektorit publik, të tilla si: të dhëna kërkimore-shkencore, strategji, raporte, statistika, harta, matje, vendime/rekomandime, etj. Nëpërmjet këtij ligji garantohet një politikë e qartë dhe e posaçme, duke inkurajuar mundësinë e ripërdorimit të informacionit të sektorit publik në funksion të zhvillimit ekonomik.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



Komisioneri KDIMDP



IDP Albania



idp.albania



IDP Albania